



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 08 18-24 Shkurt 2019

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

3 rrethe ose 8% (=3/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:
HAS, M. MADHE, PEQIN,

33 rrethe ose 92% (=33/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIË, KUÇOVË, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 08

| | JAVA 08 |
|----------------------------|---------------|
| DIARRE PA GJAK | 1.483 |
| DIARRE ME GJAK | 0 |
| INF. RESP. TE SIPËRME | 1.3471 |
| INF. RESP. TE POSHTËME | 7.238 |
| RASH ME TEMPERATURË | 50 |
| VERDHEZA | 1 |
| HEMORRAGJI ME TEMPERATURË | 0 |
| SUSPEKT MENINGITIS | 0 |
| ETHE TË PASHPJEGUESHME | 0 |
| Numri i Njësive Raportuese | 398 |
| % e Njësive Raportuese | 93% (398/427) |

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog 36 raste si më poshtë nuk janë të dyshuara për fruth dhe rubeolë por për varicelë:

Fier – 13 rast

Vlorë – 23 raste

Ndërsa të dyshuar për Fruth janë 5 raste raste nga rrethi i Tiranës, 3 raste nga rrethi Lezhës, 2 raste nga rrethi i Durrësit, dhe nga 1 rast nga rrethet Shkoder, Lushnje, Tepelenë dhe Vlorë.

Verdhëza


Rasti është i grupmoshës 60+ vjeç i raportuar nga rrethi i Fierit. Më pas diagnoza rezultoi me natyrë jo infektive.

Rast vdekje nga Gripi


Një paciente e moshës 36 vjeç e konfirmuar me Grip ka përfunduar në vdekje. Pacientja ishte shtatëzanë me binjakë dhe ishte shtruar ne Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive "Shefqet Ndroqi". Pacientja nuk ishte vaksinuar ndaj gripit.

Infeksione respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Prirja në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet rënie në javën e 08 krahasuar me javën paraardhëse, java 07

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Prirja në kohë i “Diarreve pa gjak” paraqet rënie në javën 08 krahasuar me javën paraardhëse, java 07

Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 01 – 08 të vitit 2018 dhe të vitit 2019. Numri i rasteve.




Në javën e 08 të vitit 2019 vërehet prirje në rënie e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 20% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës në javën 08 të vitit 2019. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)




Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000



Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën 07 dhe 08 të vitit 2019. Incidenca (raste/10.000)




Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët 01 – 08 të vitit 2018 dhe të vitit 2019. Numri i rasteve.



Në javën 08 të vitit 2019 vërehet prirje në rënie e numrit të rasteve të “Diarre pa gjak” dhe ky numër është 15% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën 07 dhe javën 08 të vitit 2019. Incidenca (raste/10.000)



Nga komunikimi me rrethet, shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Nga komunikimi me rrethet që kanë rritje të rasteve nuk janë evidentuar shpërthime epidemike.

Nivelet e Raportimit për javën e 08 sipas rretheve, në përqindje.

